



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 19

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 30 prill 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit nr. 1313, datë 29.3.2018	Vendim i Komisionit të Ankimit ndaj subjektit fizik/juridik “Fatjon Dana”, protokolluar me nr. 3705 prot., datë 3.8.2017..... 3
Njoftim i Fondit Shqiptar të Zhvillimit nr. 625, datë 24.4.2018	Ftesë për ofertë, për procedurën e konkurrimit “Tender i hapur kombëtar”, me objekt: “Rikonstruksion dhe zgjerim i rrugës “Muzak Topia”, segmenti nga rrethrrrotullimi tek ish-Rezervat e Shtetit deri te labidari në kala”, financuar nga Banka Botërore..... 3
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 116/1, datë 26.4.2018	Për shitje me ankand të pronës shtetërore në administrim të Bashkisë Kukës dhe të Ministrisë së Mbrojtjes..... 4



VENDIM

Nr. 1313, datë 29.3.2018

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të Ligjit 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 103, datë 4.2.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, të ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 695, datë 10.11.2017, dhe të ankimit për vendimin përfundimtar me nr. 1, datë 17.7.2017, të ISHMPU-së, Dega Rajonale Tiranë, ndaj subjektit fizik/juridik “Fatjon Danaj”, protokolluar me nr. 3705 prot., datë 3.8.2017,

Komisioni, si rezultat i vlerësimit të procedurës së ndjekur nga grupi i inspektimit të ISHMPU-së, Dega Rajonale Tiranë dhe kundërvajtjes së subjektit “Fatjon Danaj” referuar germës “a”/“iii”, të nenit 29, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar,

VENDOSI:

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar:

Lënien në fuqi të vendimit të dënimit nr. 1, datë 17.7.2017, në vlerën 300.000 lekë dhe dënimit plotësues të marrë nga ISHMPU-ja, Dega Rajonale Tiranë.

KRYEINSPEKTOR I KOMANDUAR
NË DETYRË

Armando Lamaj

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

NJOFTIM

Nr. 625, datë 24.4.2018

**PËR PROCEDURËN E KONKURRIMIT
“TENDER I HAPUR KOMBËTAR”,
ME OBJEKT: “RIKONSTRUKSION DHE
ZGJERIM I RRUGËS “MUZAK TOPIA”,
SEGMENTI NGA RRETHROTULLIMI
TEK ISH-REZERVAT E SHTETIT DERI
TE LABIDARI NË KALA”, FINANCUAR
NGA BANKA BOTËRORE**

FTESË PËR OFERTË

Shqipëri

Projekti për integrimin urban dhe zhvillimin e turizmit

Hua nga IBRD-ja nr. 8656- ALB

Titulli i kontratës: “Rikonstruksion dhe zgjerim i rrugës “Muzak Topia”, segmenti nga rrethrotullimi tek ish-Rezervat e Shtetit deri te lapidari në kala”

Referencë: AL – ADF – 15545 – CW – RFB

Lëshuar në datën: 25 prill 2018

1. Qeveria e Shqipërisë ka marrë një financim nga Banka Botërore kundrejt kostos së projektit: “Integrimi urban dhe zhvillimi i turizmit” dhe ka për qëllim të përdorë pjesë të këtij financimi për kontratën “Rikonstruksion dhe zgjerim i rrugës “Muzak Topia”, segmenti nga rrethrotullimi tek ish-Rezervat e Shtetit deri te lapidari në kala”.

2. Fondi Shqiptar fton tani ofertues të kualifikuar për të paraqitur ofertat e tyre për punimet civile, “Rikonstruksion dhe zgjerim i rrugës “Muzak Topia”, segmenti nga rrethrotullimi tek ish-Rezervat e Shtetit deri te lapidari në kala”, që parashikohen të kryhen për një periudhë kohore prej 12 muajsh.

3. Tenderi do të zhvillohet në bazë të një dokumentacioni të harmonizuar ndërmjet dokumentacionit për prokurimin e tenderit të hapur sipas Agjencisë së Prokurimit Publik dhe standardeve të Bankës Botërore, duke u realizuar sipas procedurave të përcaktuara në udhëzuesit e Bankës Botërore, për: “Prokurimi i mallrave, punët dhe shërbimet jokonsultuese nën Huat IBRD dhe kreditë IDA & grantet nga huamarrësit e Bankës Botërore”.

Ju lutemi, referojuni paragrafëve 1.6 dhe 1.7 për politikën e Bankës Botërore për konfliktin e interesit.



4. Ofertuesit/kompanitë e interesuar/a mund të marrin informacion më të detajuar nga **Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)** dhe të kontrollojnë dokumentet e tenderimit gjatë orareve zyrtare nga 09:00 deri 16:30, në adresën e dhënë më poshtë:

Emri: Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)

Adresa: Rruga “Sami Frashëri”, nr. 10, Tiranë

Tel.: +355 4 2235 597/8

Fax: +355 4 2234 885

E-mail: eqirjaqi@albaniandf.org

Adresa e internetit: <http://www.albaniandf.org>

5. Një set i plotë i dokumenteve të tenderimit në shqip mund të blihet nga ofertuesit e përshtatshëm të interesuar, sipas paraqitjes së një aplikimi të shkruar në adresën e mëposhtme dhe sipas pagesës së një takse të pakthyeshme prej 15,000 ALL. Mënyra e pagesës do të jetë me transfertë bankare, në favor të:

Emri i llogarisë: Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Emri i bankës: Union Bank

Emërtimi i llogarisë: Llogari Projekti ADF

Numri i klientit: 285464

IBAN CODE: AL80 2141 1106 0111 2854 6403 0117

6. Ofertat duhet të dërgohen në adresën e mëposhtme në ose para **25.5.2018, ora 10:00**. Ofertat elektronike nuk do të lejohen. Ofertat e vonuara do të refuzohen. Ofertat do të hapen

publikisht në prezencë të përfaqësuesve të caktuar të ofertuesve dhe kujtdo që zgjedh të marrë pjesë, në adresën e mëposhtme, më **25.5.2018, ora 10:00**.

7. Të gjitha ofertat duhet të shoqërohen nga një sigurim oferte me vlerë **5,750,000 lekë (pesë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë)**.

8. Adresa/at e referuar/a më sipër është/janë:

Emri: Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)

Adresa: Rruga “Sami Frashëri”, nr. 10, Tiranë

Tel.: +355 4 2235 597/8

Fax: +355 4 2234 885

E-mail: eqirjaqi@albaniandf.org

Adresa e internetit: <http://www.albaniandf.org>

NJOFTIM

Nr. 116/1, datë 26.4.2018

PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË BASHKISË KUKËS DHE TË MINISTRISË SË MBROJTJES

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, kapitulli III, shpall për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:

1. Në administrim të Bashkisë Kukës

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + truall)	Mjetet kryesore	Truall			Data	Ora	Vendi
1	Salla e Mbledhjeve (kati përdhes)	Kukës	4 298 912	3 689 412	609 500	243.8	209.9	22.5.2018	10:00	DDPP

1. Në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes

Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
		Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + truall)	Mjetet kryesore	Truall			Data	Ora	Vendi
Objekteve 1–7 të pronës nr. 1046, me emërtesë “Ish-N/Reparti AKA 2825”	Kala, Berat	9 682 907	7 128 681	2 554 226	801.2	801.2	22.5.2018	11:00	DDPP



Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë Komisionit të Ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** në origjinal që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë Komisionit të Ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimsht brenda afatit të pranimit të kërkesave.

3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. **Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimi etj. nëse ka të tilla.

5. **Deklaratë noteriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimsht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave: www.financa.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2018